REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

NR.19, DATË 16.03.2018

PËR

"MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR.43, DATË 22.09.2016, "PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË PORTABILITETIT TË NUMRIT""

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 16.03.2018, sipas proçedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe Rregullore e Brendshme për "Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare" miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

"Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit""

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 "*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar (***ligji nr. 9918***);

2. Rregullore Nr.43, datë 22.09.2016 *"Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit"* **(Rregullore);**

3. *"*Udhëzues për procedurat e këshillimit publik*"*, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1183, datë 10.03.2010;
4. Urdhër Nr.257, datë 12.11.2017, per *"Ngritjen e grupit të punës për amendimin e Rregullores Nr.43, datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit""*.
5. Vendim i Këshillit Drejtues Nr.26, datë 21.12.2017 për "*Miratimin për këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*".

K Ë SH I LL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin "*Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*"";
- Dokumenti për "*Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*"";
- Dokumenti "*Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.43*";
- Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me VKD Nr.26, datë 21.12.2017 miratoi për këshillim publik dokumentin mbi "*Disa ndryshime në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*""
2. Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të internetit të AKEP dhe periudha e këshillimit publik ishte 26.012.2017-26.01.2018. Në përfundim të afatit të këshillimit publik, në adresë të AKEP kanë dërguar komente palët e mëposhtëme të interesuara:
   - Vodafone Albania sh.a me shkresën datë 25.01.2018 Ref. LEA/007/IL (AKEP nr. prot 2239/4 datë 29.01.2018);
   - Telekom Albania sh.a me shkresën datë 25.01.2018 me nr.620 prot (AKEP nr.2239/5 prot datë 30.1.2018);

- Albtelecom sh.a me shkresën datë 26.01.2018 me nr.886 prot (AKEP nr.2239/3 prot datë 26.1.2018) me objekt "Komente të Albtelecom mbi disa ndryshime në Rregulloren Nr.43, dt 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit";
- Operatori i CRDB në rrugë elektronike me email më datë 29.01.2018.

3. Grupi i Punës së AKEP ka komunikuar me palët e interesuara që kanë dërguar komente pas këshillimit publik duke zhvilluar një takim më datë 12.02.2018, dhe më datë 9.03.2018 i ka dërguar palëve të interesuara në rrugë elektronike me email një version të rishikuar të ndryshimeve pas këshillimit publik dhe takimit me palët e interesuara. Të katër palët e interesuara kanë kthyer përgjigje në rrugë elektronike me email për versionin e rishikuar të GP, i cili pasi ka marrë në konsideratë të gjitha komentet në proceset e përshkruara më sipër ka përgatitur dokumentacionin final për miratim në Këshillin Drejtues të AKEP.
4. Dokumenti "*Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.43*", paraqet komentet e të gjithë sipërmarrësve (palëve të interesuara) për çështjet e ngritura dhe qëndrimin e AKEP për komentet.
5. Dokumenti "*Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*"" i propozuar nga Grupi i Punës është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me synimet dhe funksionet e AKEP për përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 si dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2018, si dhe ka marrë në konsideratë komentetet e palëve të interesuara në këshillim publik.
6. Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga Grupi i Punës në përputhje me kërkesat proceduriale të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të AKEP.
7. Bazuar në problematikat e evidentuara, AKEP çmon si të rëndësishme amendimin e Rregullores Nr.43, datë 22.09.2016 "*Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*". Ndryshimet e miratuara pas këshillimit publik synojnë lehtësimin dhe optimizimin e procesit të portimit të numrave, ndër të tjera nëpërmjet:
    a. Përdorimit të Numrit Personal të Identifikimit i cili është numri unik personal që gjendet në Kartën e Identitetit, Pasaportën, Certifikatën e lindjes së cdo personi në RSH dhe që propozohet të jetë kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit, si dhe mundësisë për saktësim të shpejtë dhe pa vonesë të këtij numri në bazën e të dhënave të operatorit dhënës;
    b. Përdorimin e Numrit Personal të Identifikimit si kriteri kryesor për identifikimin e pajtimtarit dhe heqjen e kriterit të refuzimit për shkak të mospërputhjes së emrit/mbiemrit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës me kërkesën për portim (mjafton përputhshëmri e Numrit Personal);
    c. Shtimit dhe saktësimit të disa përkufizimeve për numrat që mund të portohen;
    d. Publikimin nga AKEP të raporteve periodike për portimet dhe perfomancën e secilit operator për portabilitetin, përfshirë afatet, refuzimet etj.;
    e. Përfshirjen e përcaktimit në rregullore që koha e aktivizimit të numrit të portuar nuk duhet të jetë me gjatë se një 1 ditë pune nga koha e kërkesës për portim dhe rasteve përjashtimore nga ky afat;
    f. Zgjatjen e orarit të pranimit të kërkesave për portim si dhe të kapacitetit ditor të pranimit dhe përgjigjeve të kerkesave për portim;

g. Përfshirjen në rregullore të mundësisë së AKEP që bazuar në raportet e CRDB si dhe në ankesat dhe mosmarrveshjet e pajtimtarëve për portimin e numrit (përfshirë statistikat për ankesat) të marrë masa proporcionale për shkeljet adminsitrative të operatorëve për portabilitetin e numrit.

8. Bazuar në nenin 110/pika 4 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar dhe "Udhëzuesin për procedurat e këshillimit publik", AKEP-i duhet të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në nenin 114 dhe nenin 115 të Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentat:
   a. "*Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*"";
   b. *"Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.43"*.
2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuara në pikën 1 më sipër të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP www.akep.al.

3. Kundra këtij vendimi palët e interesuara mund të ankimohen sipas Kodit të Procedurës Administrative.

   Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

ILIR ZELA

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**